



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit të vitit 2023, mbajtur më 11.08.2022, i cili filloi në orën 14:00.

Në dëgjimin publik morën pjesë: **Ramë Ajeti, Ismet Haziri, Avdullah Krasniqi, Qerim Ademi, Sabit Bllaca, Sadudin Hasani, Gëzim Sveçla, Violeta Salihu, Arben Kelmendi, Driton Hoxha, Arta Rafuna, Enver Llumnica, Shaqir Kqiku, Milazim Vitija, Amir Simnica, Fisnik Osmani, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Xhemshit Lllapashtica, Muhamed Luta, Safet Krasniqi, Fevzi Bajrami, Imer Rrahmani, Vehbi Krasniqi, Ilmi Uka, Gëzim Zeqiri, Sokol Krasniqi, Bujar Gashi, Ilmi Reçica, Naser Gashi, Bajram Sopi.**

Morën pjesë edhe: **Alban Zogaj**, nënkryetar, **Valbona Makolli**, drejtore e Drejtorisë së Financave, **Bersant Beka**, drejtor i Drejtorisë së Administratës, **Ilirik Musliu**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, **Krenar Xhaferi**, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave.

Mbledhjen e kryesoi dhe e udhëhoqi **Osman Bllaca**.

Osman Bllaca fillimisht i përshëndeti të pranishmit duke ju uruar mirëseardhje në dëgjimin publik për hartimin e buxhetit 2023/2025. Sot ju kemi ftuar kryetarët e bashkësive lokale, të lagjeve dhe fshatrave, me qëllim që ti marrim diskutimet prej juve, që ti identifikojmë ato kërkesa, cilat janë me prioritet për lagjet dhe fshatrat e juaja.

Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave tha se Komuna e Prishtinës për vitin 2023, sipas qarkores së parë që e ka pranuar nga Ministria e financave, së bashku me ligjin e kryeqytetit, do të ketë për vitin 2023 1.495.981 euro, për të gjitha kategoritë ekonomike.

Kjo shumë është e ndarë në pesë kategori ekonomike, në paga dhe mëditje, mallra, shërbime komunal, subvencione dhe investime kapitale. Nga kjo vlerë 33 milion, do të jenë për paga dhe mëditje, 27 milion e 500 mijë, për mallra dhe shërbime, për komunal 2 milion e 700 mijë, subvencione 4 milion e 650 mijë dhe investime kapitale 40 milion e 156,981 mijë.

Udhërrëfyesin që e kemi ofruar sot për ju është nga drafti i kornizës afatmesme i buxhetit të Komunës së Prishtinës, mirëpo këto janë vetëm propozim buxhete, që me kërkesat tuaja mund të ndryshojnë

Qerim Shabani, kryetari i bashkësisë lokale në Llukar, kërkoi nga ekzekutivi i Komunës që, për këtë bashkësi lokale të ndahen 700 - 900 mijë euro.

Në kër bashkësi lokale nuk kemi kanalizim, projekti për rrugën Siçevë – Sharban është i gatshëm por në mungesë të mjeteve nuk po realizohet, kështu që nuk duhet me u nda buxhet për ato bashkësi që nuk ka projekte. Kërkoi të dijë se ku janë 300 mijë euro që janë nda për ujësjellës për Mramur dhe Rimanishtë, projekt i cili nuk po realizohet.

Safet Kamberaj, kryetar i bashkësisë lokale lagja “Dardani” tha se kam disa kërkesa dhe propozime siç janë:

Në platon e “Kurrizit”, të gjitha lokalet e bizneseve kanë probleme, ku mungon, sinjalizimi, ndriçimi, fasadimi dhe janë në rrezik edhe lokalet, pastaj kërkojmë të restaurohen dy pllato, dhe rruga “Ilaz Kodra”. Kërkojmë rregullimin dhe izolimin e qendrës tregtare “28 Nëntori” afër postës, aty janë afër 250 lokale të rrezikuara nga reshjet e shiut. Po ashtu në këtë lagje është më se i nevojshëm edhe një mini treg, një shtëpi e kulturës, dy çerdhe. Gjithashtu mundësisht të shkolla “Xhemail Mustafa” të bëhet hapja e dy rrugëve që lidhë banorët nga “Kurrizi” me pjesën tjetër të rrugës. Në këtë lagje ka 3 objekte, banesa pa titullar të pronave dhe do të ishte mirë që të merret ndonjë hapë për legalizimin e tyre.

Te rrethi i madh i flamurtari në drejtim të Termokosit, të hapet një rrugë alternative, për lehtësim të komunikacionit.

Lagja Emshir, bënë pjesë në bashkësinë lokale të lagjes “Dardania” dhe ajo lagje kërkon rrugë, ujë, ndriçim, ta ket një treg, si dhe ka nevojë për vazhdimin e mbulimit të lumit Prishtina.

Naser Gashi, përfaqësues i fshatit Butovc tha se është për keqardhje që për rrugën e fshatit Butovc mos të ket asnjë euro buxhet të planifikuar, prandaj ky fshat është komplet i harruar. Që nga viti 2001, janë bërë më se 60 kërkesa, asnjëherë asnjë përgjigje, janë 5 rrugë me nga 4-5 km janë të pa kalueshme. Rruga Prishtinë-GërimKolovicë, edhe pse e prek periferinë e Butovcit, nuk e ka zgjidh problemin e këtij fshati, rrugët në brendësi të fshatit janë të pa kaluara.

Fshati jonë është mjaft atraktiv për zhvillimin e bizneseve, ka ujë të mjaftueshëm, llogaritet si fshat atraktiv por i harruar.

Ne kërkojmë që, rruga “Azem Sopi” të lidhet me fshatin Mramur.

Shërbimet komunale nuk janë në nivel, si në pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve, parqeve, etj, prandaj kërkojmë edhe një herë që kërkesat tona të merren parasysh.

Ismet Haziri, përfaqësues nga bashkësia VII lokale, fillimisht falënderoi ekzekutivin e Komunës për intervenimin në rrugën për në Zllatar si dhe kërkoi zgjerimin e saj, kërkoi ndërrimin e gypave të ujësjellësit prej azbesti në lagjen “Mat”.

Po ashtu kërkoi që të bëhet mirëmbajtja e varrezave në Zllatar, të bëhet shtrirja e ndriçimit dhe mirëmbajtja e tij. Një pjesë e banorëve të “Matit 1”, “Matiqanit” dhe “Zllatarit”, varrimet po i bëjnë në atë pjesë atje, varrezat të cilat nuk janë as të përkufizuara në sipërfaqe dhe as të mirëmbajtura. Të rregullohet shtrirja e ndriçimit dhe mirëmbajtja e tij, si dhe kërkojmë që në lagjen “Mat”, në shtëpinë e shëndetit të jet një pediatër, një stacion i policisë si dhe të vendosen pengesa në rrugë për ngadalësimin e shpejtësisë së automjeteve.

Ilmi Reçica, banor i fshatit Butovc tha se në draft propozimin buxhetor 2022/2025, janë paraparë investime për gjitha vendet, përveç fshatit Butovc. Në këtë zonë po ndërtohet pa leje, ka filluar shkatërrimi i pyjeve si dhe tjetërsimi i pronave shoqërore. Në bashkësinë lokale V , me 15 mijë banorë nuk ka çerdhe nuk ka shkollë nuk ka asgjë, andaj propozoj që të shtyhet ky debat, të shikohen dhe të analizohen mirë këto pika të rendit të ditës, e pastaj me ardhur në seancë.

Muhamed Luta, përfaqësuese i lagjes “Ramadan Shabani” në Veternik, ngriti si çështje riparimin e rrugës dhe rregullimin e ndriçimit publik, duke cekur se në vitin e kaluar në shtator e kemi bërë një kërkesë për këtë problem, por nuk kemi marrë përgjigje, dhe vërejtja se ne draft buxhetin nuk ishte e përfshirë kjo rrugë, andaj do të ishte mirë që të merren masa për kërkesat tona.

Vehbi Krasniqi nga bashkësia lokale XI, tha se personalisht unë i kam dërguar më se 20 kërkesa vitin e parë të pushteti të kaluar, nuk është realizuar asnjë kërkesë, prandaj kërkoi që këto kërkesa të merren me prioritet.

Rruga prej Fushës së pajtimit që shkon në Llukar, është e dëmtuar për shkak të rrjedhjes së kanalizimit në rrugë, dhe do të ishte mirë që të intervenohet në at pjesë. Po ashtu në rrugën “Abedin Gashi ” ka nevojë për rregullim të kanalizimit. Pastrimi i rrugëve është shumë i nevojshëm, po ashtu në këtë lokalitet është më se e nevojshme edhe ndërtimi i ndonjë çerdhe për fëmijë.

Bajram Sopi, banor nga Prishtina, me prejardhje nga fshati Butovc tha se rregullimi i rrugëve rurale është më se e domosdoshme, ndërtimi i varrezave në kryeqytet, ku varrezat e dëshmorëve kan mbetur me një projekt gjysmak, dhe se është e pakuptim që ato varreza kan mbetur në at gjendje.

Shaqir Kqiku, nga lagja “Kalabria” tha se është e vërtetë që lagja jonë është në ndërtim e sipër, kemi shumë probleme, por që 29 vite i kaluam pa rrugë, pa kanalizim, me probleme të vërshimit, të qenve endacak etj. Nuk kemi ndriçim, hapësira rreth shkollës është e tmerrshme, nuk ka trotuar për fëmijët e asaj shkolle, kështu që Komuna shumë pak ka interesim për at lagje. Në qendrën e mjekësisë familjare tonë nuk kemi pediatër etj.

Amir Simnica, anëtar i Kuvendit të Komunës dhe në cilësinë e banorit të lagjes “Muhaxhirët” tha se QMF-ja nuk është e funksionalizuar në tërësi, mungojnë shërbimet dentare, mungon ndriçimi i rrugëve, po ashtu është më se i domosdoshëm edhe intervenimi urgjent në ashensorët në banesat te “Aktashi”, ku aty banojnë më shumë se 100 familje vetëm një ashensor është funksional.

Sokol Krasniqi - ish drejtor në Komunën e Prishtinës, njëherit edhe anëtar i Kuvendit Komunal tha se në fshatin Butovc rruga është e shtruar me zhavorr dhe punimet jan ndërprerë dhe nuk kan vazhduar më tutje, mendoj se kjo qeveri do ti mbajë premtimet dhe do ti kryej ato punë ku kan ngelur në gjysmë. Po ashtu do të ishte mirë që shtyllat të cilat jan vendosur në mes të rrugës nga IPKO-ja të hiqen ato që mos të ndodh ndonjë fatkeqësi si dhe mundësisht të identifikohet problemi i kanalizimit. Gjithashtu ceku se rruga e asfaltuar Kolovicë – Butovc- Gërmë e investuar nga Komuna e Prishtinës, pjesa e Matiqanit është dëmtuar nga kamionët, ta riktheni në gjendjen që ka qenë, sepse ka mundësi për fatkeqësi fatale. **Enver Llumnica**, banor nga Barileva, në lagjen “Llumnica” tha se për këtë fshat, konkretisht në lagjen “Llumnica” nuk është bërë asgjë nga Komuna, përveç një gjysmë kanalizimi edhe ai ka mbetur në gjysmë. Një rrugë e kemi shtruar me vet kontribut, prandaj kërkesa jonë është që me riparuar ose me i rindërtuar rrugët dhe rrugicat e lagjes nëse ka mundësi, si dhe kanalizimi të përfundoj sa më shpejtë. **Ramë Ajeti**,

nga bashkësisë lokale VII, lagja e “Muhaxhirëve”, paraqiti disa probleme të kësaj lagje siç janë: problemi me ndriçimin e rrugëve, problemi me pusetat në rrugën “Ali Pashë Tepelena”, ka më se 40 vjet që nuk janë fasaduar ndërtesat e vjetra, problemi me kontejner, problemi me parking të automjeteve, si dhe mungesa e një lifti në objektin ku banojnë më se 100 banor, dhe një lift i cili është në funksion nuk i përmbush nevojat e qytetarëve.

Feim Osmani, kryetar i bashkësisë lokale Besi, që përfshinë edhe fshatrat, Rimanishtë, Tenezhdoll, Vranidoll dhe Siçevë, ceku disa kërkesa të cilat nuk janë përfshirë në propozimin e buxhetit për vitin 2022, dhe që kanë qenë që një kohë bukur të gjatë, si për vazhdimin e rregullimit të rrugicave të fshatrave Rimanishtë, Tenezhdoll dhe Besi. Lidhur me këtë ai ceku se është më se i nevojshëm zgjerimi i urës në rrugën “15 Marsi”, rregullimi i shtratit të lumit Llap në Tenezhdoll, dhe betonimi i pjesëve të caktuara të cilat vërshojnë çdo vit. Po ashtu ndërtimi i parqeve, vazhdimin e rrugës “2 prilli” në Besi, për 700 metra, deri te shtëpitë e fundit. Në Rimanishtë dhe Tenezhdoll zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik, linjën e trafikut urban për fshatin Tenezhdoll, mirëmbajtja e rrugëve të kategorisë së tretë, sidomos anash nga shkurret, dhe pastrimi i kanaleve anësore, furnizimi me ujë të pijshëm sidomos për fshatin Rimanishtë dhe Sharban, kërkesa këto të gjitha të protokolluara.

Sadudin Hasani, kryetar i bashkësisë lokale qendër, Prishtinë tha se kjo bashkësi lokale ka një hapësirë shumë të vogël dhe nuk e plotëson asnjë kusht të punës. Kërkoi që në QKMF, në objektin ku është pediatria dhe gjinekologjia, të vendoset urgjent një ashensor, të bëhen pjerrina të veçanta për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara, të ndërrohen mbulojat e kulmeve pasi që në disa vende janë prej azbesti. Po ashtu kemi nevojë edhe për 3 fusha tjera sportive, furnizimin me libra për bibliotekat shkollore, sanimi i kanalizimit në rrugën “Johanes Van”. Gjithashtu është një kërkesë për me u ndërtuar një çeshme në sheshin “Zahir Pajaziti” dhe deri më tani nuk është ndërtuar.

Gëzim Sveçla, anëtar i Kuvendit të Komunës tha se kërkesat e mia kanë të bëjnë me pjesën e vjetër të qytetit, konkretisht me disa rrugë të cilat janë të shtruara me kalldrëm, ku për shkak të intervenimeve të ndryshme, që i kanë pasur banorët e atyre lagjeve, tashmë ato rrugë janë bërë vështirë të kalueshme, konkretisht rruga “Antigona Fazliu”, rruga “Adem Gllavica”, rruga “Mbreti Bardhyl” dhe rruga “Maliq Pashë Gjinolli”, që janë afër shkollës Emin Duraku, të gjitha këto rrugë kanë nevojë për riparimin e tyre.

Sabit Bllaca, banor i bashkësisë lokale në Besi, tha se në lagjen “Bllaca” mungon rruga, është e shtruar me gurë dhe tani duhet të shtrohet me asfalt.

Në emrin e ish - kryetarit të bashkësisë lokale të lagjes “Bregu i Diellit”, kërkoi shtrirjen e rrjetit të ngrohtores për objektet të “Banesat e bardha”, rregullimin e hapësirave të gjelbëruara, rregullimin e ashensorëve, lirimimin e trotuareve në rrugën “Isë Kastrati”, rregullimin e varrezave të dëshmorëve, rregullimin e ndriçimit, në veçanti për rrugën “Parashqevi Çiriazit” dhe furnizimi me kontinier.

Mbledhja përfundoi në orën 15:50

Procembajtësi

Zijadin Gashi

Pjesëmarrja në diskutime publik lidhur me Planifikimin e buxhetit të vitit 2023,

më 11.08.2022.

	Emri dhe Mbiemri	Gjinia M/F	E-mail	Nënskrimi
1	RANË AJETI 091485-083			
2	ISMET HAZIRI			
3	ABDULLA KENSURI			
4	Asyiam Alesani			
5	Selvet Bllaga			
6	Shmirit Celina			
7	SADRID HASANI			
8	GEJAN SUECIS			
9	Violeta Sullhu			
10	Arhem Kelumuci			
11	DIETON DORHA			
12	Arta Rafuna			
13	EKNER LLUMKHA			
14	SHADIK KAIK			
15	MILASHIM VITIQA			
16	AMIR SIMNICA			
17	FISNIK OSMANI			

18	ETA RAFINA			
19	Dorjeta Darguba			
20	Khemnit Lepolthica			
21	Muhammad Luta			
22	Safet Zharriyev			
23	Felzi Rajinani			
24	Yana Gakhov			
25	Yetti Karsvici			
26	Ami Mea			
27	Greiv Zevis			
28	Sokol Krasuji			
29	BUSAR GASHI			
30	LENI RECYCH			
31	Naser Gashi			
32	BPJRAH SOPI			
33	Ded. Miley 81.5			
34				
35				
36				
37				
38				
39				